



## KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE

### EKSTRAKT

**nga procesverbali i mbajtur më 23 prill 2018, në mbledhjen e I-rë (parë, mbledhja konstituive) të Komitetit për Komunitete, mandati VI.**

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 11.00’.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: Valbona Kadriu-Podvorica, Benjamin Ejupi, Doruntina Hasani, Bashkim Sylja, Shaban Ahmeti, Valmire Jahu, Albina Avdiu, Radisav Perović, ndërsa mungoi, Mefail Rama.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Bashkim Bajrami, Policia Kufitare, Fadil Babatinca Policia e Kosovës, Bekim Karaxhija nga OSBE, dhe Angela Tamara Magera KFOR - LMT.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues,** e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit. Theksoi, nga pozita e Kryesuesit të Kuvendit do të kryesoj mbledhjen deri në zgjedhjen e Kryesuesit të Komitetit për Komunitete, sikurse që është paraparë në rend dite. Në bazë të listës së nënshkrimeve mungon z. Mefail Rama, pra mund të konstatojmë se ka kuorum dhe mund të fillojmë me punë. Themelimi i këtij Komitetit është në vonesë për shkak të procedurave të shqyrtimit administrativ nga MAPL e cila është përgjegjëse për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve të Komunës si dhe procesit të rishqyrtimit të vendimit të Kuvendit të Komunës për themelimin e Komitetit për Komunitete. Gjatë procesit të rishqyrtimit të aktit janë marrë për bazë vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga MAPL dhe struktura gjinore e Komitetit është bërë në përputhje me parashikimet e Ligjit për Barazi Gjinore. Besoj se keni qenë me kohë të informuar për mbledhjen dhe rendin e ditës.

### **Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri.*

### **1. Zgjedhja e Kryesuesit dhe Zëvendës Kryesuesit të Komitetit për Komunitete**

**z.Fatmir Gashi, Kryesues,** theksoi, sikurse jeni në dijeni, në bazë të rregullat ivës ligjore kryesuesi i Komitetit për Komunitete zgjidhet nga komunitetet pakicë, atëherë e keni fjalën dhe mund të filloni me propozime konkrete.

**z.Liman Zeqiri,** theksoi, desha të bëj një sqarim të shkurtër. Është fakt dhe çështje e rregulluar me dispozita ligjore se Kryesuesi i këtij Komiteti vjen nga radhët e Komuniteteve pakicë, mirëpo duke qenë se në bazë të të dhënave zyrtare komuniteti ashkali del të jetë komuniteti me numrin

më të madh të qytetarëve në raport me komunitetet tjera pakicë dhe në këtë rast duke u bazuar se në kuadër të këtij Komiteti janë tre(3) përfaqësues të komunitetit ashkali, një përfaqësues i komunitetit rom dhe një përfaqësues i komunitetit serb, sipas kësaj strukture de fakto dhe ligjërisht kryesimi i këtij komiteti i takon komunitetit ashkali, kështu ka qenë edhe në mandatet tjera, ndërsa Nënkryesues i Komitetit për Komunitete mund të jetë edhe nga radhët e përfaqësuesve të Kuvendit.

**znj.Valmire Lahu**, theksoi, për Kryesues të Komitetit për Komunitete propozoj z. Shaban Ahmeti. I përmenduri ka qenë kryesues i këtij Komiteti edhe në mandate të mëparshme dhe si rezultat vlerësojmë suksesshëm angazhimin dhe punën e bërë.

**znj.Albina Avdiu**, përshëndetje të gjithëve, për ata që nuk më njohin unë jam Albina Avdiu dhe vij nga radhët e komunitetit ashkali, ndërsa me profesion jam gazetare. Gjithashtu edhe unë propozoj z. Shaban Ahmetin për Kryesues të këtij Komiteti.

**z.Radisav Perović**, theksoi, gjithashtu edhe unë përkrah propozimet e dy parafoseve.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues**, nga tri propozimet e paraqitura, rezulton që z. Shaban Ahmeti të jetë kandidati i vetëm për Kryesues të Komitetit. E hedh në votim.

**Konstatim:**

*Pas votimit njëzëri z.Ahmet Shabani zgjedhët Kryesues i Komitetit për Komunitete.*

**z.Shaban Ahmet**, theksoi, unë ju falënderoi për besimin dhe për këtë mundësi që edhe këtë mandat të kryesoj Komitetin për Komunitete. Dua të konfirmoj se ky Komitet është vlerësuar si një prej Komiteteve më të suksesshëm në punët dhe aktivitetet që ka ndërmarrë. Llogarisë që së bashku të vazhdojmë me këtë trend, me përkushtim për punë dhe angazhime të mëtejme.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues**, theksoi, përveç Kryesuesit duhet zgjedhur edhe zëvendës kryesuesi i Komitetit për Komunitete. Mund të filloni me propozime

**z.Shaban Ahmeti, kryesues i sapo zgjedhur**, theksoi, propozoj znj. Albana Kadriu Podvorica kandidate për Zëvendës kryesuese të KK.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues**, meqë nuk ka propozime të tjera, propozimin e parafolësit për zgjedhjen e zëvendës kryesues të KK e hedh në votim.

**Konstatim:**

*Pas votimit njëzëri znj.Valbona Kadriu Podvorica zgjedhet Zëvendës kryesuese e Komitetit për Komunitete.*

**z.Fatmir Gashi, Kryesues**, pas përfundimit të procesit të zgjedhjes së Kryesuesit dhe Zëvendës kryesueses së KK, e ftoj z. Shaban Ahmeti kryesues i sapo zgjedhur të marr kryesimin e dhe të vazhdoj me punën e Komitetit.

**z.Shaban Ahmeti kryesues**, fillimisht falënderoj Kryesuesin e Kuvendit të Komunës për kryesimin e mbledhjes ndërkaq vazhdojmë me pikat e rendit të ditës.

## **2. Ngritja e Grupit punues për hartimin e planit të punës së komitetit për Komunitete për vitin 2018**

**z. Shaban Ahmeti kryesues**, dua të theksoj se kontribut të jashtëzakonshëm në përgjithësi në punën dhe aktivitetet e këtij Komiteti ka dhënë z. Liman Zeqiri, shef i Zyrës komunale për Komunitete dhe Kthim. Ka një përvojë dhe kështu do të na orientoj edhe lidhur me përgatitjen e planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2018.

**z. Liman Zeqiri**, theksoi, ne kemi bërë një praktikë për mënyrën e përgatitjes dhe hartimit të Planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2018. Meqë kemi një përbërje të re të Komitetit, fillimisht i përshëndes asamblistët e rinjë, anëtarë-të këtij Komiteti, duke u dëshiruar shëndet dhe punë të mbarë. Mendoj se në mandatet e kaluara kemi pasur raporte të mira të ndërsjella pasi që jemi Komitet shumë i hapur, sepse merremi me tema që i referohen si komunitetit pakicë ashtu edhe shumicë, si me brenga ashtu edhe me shqetësime tona në përgjithësi. Atë që e theksoi Kryesuesi, si Komitet kemi qenë dhe jemi një shembull i mirë edhe në rajon, çdo çështje është debatuar qartë dhe mirë dhe në kuadër mundësive tona jemi munduar të ndihmojmë në çdo aspekt. Sikurse e theksoi kryesuesi i Asamblesë komunale, jemi vonuar pak me këtë ritëm, mirëpo kjo është bërë për shkak të procedurave ligjore, konkretisht te respektimi i kuotës së barazisë gjinore, megjithatë ne me punë dhe angazhimet tona mund t'i mbërrijmë çështjet që do t'i parashohim në Planin e punës. Pra për hartimin e planit të punës duhet të ngritet një grup punues nga përbërja e Komitetit, i cili grup mund të ndihmohet edhe nga Zyra jonë por edhe nga Zyra ligjore në aspektin profesional. Sigurisht se Kryesuesi i Komitetit duhet të kryesoj grupin, ndërsa për anëtarët tjerë të grupit mund të fillohet me propozime.

### Konstatim:

*Pas propozimeve dhe procesit të votimit u ngrit grupi punues për hartimin e planit të punës së Komitetit për Komunitete në përbërje:*

1. Shaban Ahmeti, kryesues
2. Bashkim Sylja, anëtar
3. Doruntina Hasani, anëtare
4. Albina Avdiu, anëtare
5. Benjamin Ejupi, anëtar

**z. Shaban Ahmeti, kryesues**, theksoi , Grupi punues i sapo formuar, së shpejti do të takohet dhe brenda një afati të shkurtër do të përgatisë draftin e planit të punës i cili do të vihet në shqyrtim në Komitet. Nëse nuk ka dikush diçka rreth kësaj çështjeje kalojmë në pikën e radhës.

## **3. Të ndryshme**

**z. Shaban Ahmeti kryesues**, nëse dikush ka diçka në të ndryshme mund ta merr fjalën.

**z. Fadil Babatinca**, pasi që është takimi parë, po prezanto hem , jam Fadil Babatinca, jam pjesëtar i Policisë së Kosovës, në Njësinë e komunitetit pran Stacionit Policor në Podujevë. Sa për fillim do ju njoftoja për situatën e sigurisë në zonën tonë të përgjegjësisë. Duke ju falënderuar bashkëpunimit që kemi pas me të gjitha strukturat, përfshirë komunitetet kemi një situatë të qetë dhe të sigurt.

Sigurisht se jeni të informuar për publikimin e konkursit për pranimin e policëve/eve në radhët e Policisë së Kosovës, kështu që kisha kërkuar nga Ju, sepse unë edhe ashtu kam biseduar shumë me qytetarë të Komuniteteve pakicë, për t'i bindur, sqaruar, udhëzuar dhe t'i inkurajoni që të aplikojnë numër sa më i madh i tyre.

**z.Liman Zeqiri**, për temën e ngritur nga parafolësi, dua të theksoj se duke falënderuar OSBE-në ne edhe në vitin 2016 kemi pasur të njëjtën ide, ku në mesin e disa komunave kanë zgjedhur edhe Komunën tonë për bashkëpunim, sepse ka qenë një bashkëpunim i jashtëzakonshëm, i gjithanshëm dhe nga kjo falënderoj publikisht OSBE-në sepse kanë bërë edhe senzibilizimin e kësaj teme. Pas hapjes së konkursit u kërkuar që një numër deri në 12 persona-kandidatë t'i dërgojmë për trajnim në Akademinë Policore në Vushtrri ku transportin dhe të gjitha shërbimet ju kanë siguruar dhe ne fuqishëm i kemi përkrahë. Ne këtë e mirëpresim, mirëpo është mirë të bëhet edhe një senzibilizim ta quaj shtesë në mënyrë që të inkurajohen për konkurrim dhe që kjo të shfrytëzohet edhe si mundësi e integritit në shoqërinë tonë multietnike.

Sa për njoftim, sepse sigurisht që jeni në dijeni, është viti i tretë që në zbatim të rregullativës ligjore përkatëse të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, në funksion të krijimit të lehtësirave për integrimin e komuniteteve pakicë të gjitha komunat mundësojnë regjistrimin civil falas për komunitetet pakicë në muajin prill. Në kuadër të kësaj ne i kemi informuar me kohë Drejtorin e Drejtorisë së Administratës, shefin e Shërbimit të Gjendjes Civile, Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, si dhe kemi bërë ftesë edhe në lokacionet ku jetojnë komitetet pakicë, në lagje të caktuara në mënyrë që të kenë informacionet e sakta që muaji prill është falas për regjistrimin civil. Informacionet janë përcjellë edhe përmes mjeteve të informimit lokal. Komuna e Podujevës do të përkrahë këtë iniciativë, kurse Zyra e gjendjes civile do të bëjë regjistrimin falas dhe do t'i mbështes në të gjitha format pjesëtarët e këtij komuniteti pakicë, në mënyrë që procesi i regjistrimit të arrijë rezultate sa më të mira.

**z.Bekim Karaxhija- OSBE**, u prezantua, pasi që siç theksoi është një përbërje e re e Komitetit për Komunitete. Theksoi, deri më tani kemi pas një bashkëpunim të shkëlqyer me Komitetin për Komunitete, me Zyrën për Komunitete dhe Kthim por edhe me zyra të tjera dhe besoj se ky bashkëpunim do të vazhdoj. Keni qenë një shembull në mandatin e kaluar dhe besoj se do të vazhdoni në të njëjtën mënyrë. Pasi që ky është takim i konstituimit nuk kemi nevojë për të shpjeguar aktivitete edhe pse shefi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim shumë mirë këtë e pasqyroj, me theks të veçantë për punësimin e mundshëm nga radhët e Komuniteteve pakicë në Policinë e Kosovës. Ne presim sugjerimet dhe propozimet e juaja dhe ne do të mundohemi në kuadër të mundësive tona të ju ndihmojmë dhe njëherit ju dëshiroj punë të mbarë.

Kryesuesi përfundoi mbledhjen pasi që nuk pat çështje tjera për shqyrtim.

**Mbledhja përfundoi në orën 11.40'.**

**Procesverbalin e mbajti**  
**Enis Sheholli**

**Nr. 01-060/04-000033302/18**  
**Podujevë,**  
**23 prill 2018**

**Kryesuesi i mbledhjes**  
**Fatmir Gashi**

**Kryesues i Komiteti**  
**Shaban Ahmeti**